



Viti i XIV -të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2022

PËRPARËSITË DHE EFEKTET E RENDIT JURIDIK KOMUNITAR

Entiola Pano (Lazri)*; Erion Pano**

*Këshilltare Ligjore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor

Pedagoge në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Albania University

**Master Ekzekutiv, Magjistrat

Përmbledhje

Themelimi i Bashkimit European imponoi nevojën për të “konceptuar” një sërë aktesh legislative të cilat duhet të rregullonin marrëdhëniet mes Unionit dhe Shteteve Anëtare, mes Shteteve Anëtare, si dhe statusin dhe marrëdhëniet e çdo individi në komunitet. Fillimisht, duhej të përcaktohej mirë dhe qartë natyra dhe efektet e legjislacionit të Komunitetit. Institucionet duhej të ishin në gjendje të harmonizonin në mënyrë efektive dhe të pavarur nga vullneti i Shteteve Anëtare, kushtet e ndryshme ekonomike, sociale dhe madje mjedisore. Kjo duhej bërë me anë të paketave ligjore në shumë Shtete Anëtare, me qëllimin për t’iu ofruar të gjithë shtetasve të Bashkimit kushtet më të mira të mundshme për jetesë. Nga ana tjetër, Institucionet e Bashkimit European nuk mund të ndërhyjnë në sistemet juridike të brendshme të Shteteve, më shumë sesa ishte e nevojshme.

Sistemi normativ i Bashkimit European bazohet në parimin se kur një masë duhet të jetë e zbatueshme, qoftë edhe në detaje, në të gjitha Shtetet Anëtare, atëherë masat kombëtare duhet të zëvendësohen me akte ligjore të Bashkimit dhe kur kjo nuk është e nevojshme, duhen marrë parasysht rendet juridike ekzistuese të Shteteve Anëtare. Në këtë kontekst janë zhvilluar një mori instrumentesh që i mundësojnë institucioneve të Unionit të ndërhyjnë me masa të ndryshme në rendet juridike të brendshme. Si pasojë u realizua zëvendësimi i normave të brendshme me norma të Komunitetit European.

Sot Bashkimi European disponon edhe rregulla në bazë të të cilave institucionet e tij ndikojnë indirekt mbi rendet juridike të Shteteve Anëtare. Pra, ekzistojnë edhe akte jodetyruese për Shtetet Anëtare apo për shtetasit e Komunitetit.

Fjalët çelës: *Rendi Juridik Komunitar; Shtetet Anëtare; Komuniteti European; E Drejta Komunitare; Traktati i Bashkimit European*

ADVANTAGES AND EFFECTS OF THE COMMUNITY LEGAL ORDER

Abstract

The establishment of the European Union imposed the need to “conceive” a series of legislative acts which were to regulate relations between the Union and the Member States, between the Member States, as well as the status and relations of each individual in the community. Initially, the nature and influence of Community legislation had to be clearly defined. The institutions had to be able to harmonize effectively and independently of the will of the Member States the different economic, social and even environmental conditions. This had to be done through legal packages in many Member States, with the aim of providing all European Union citizens with the best possible living conditions. On the other hand, the Institutions of the European Union could not interfere in the internal legal systems of the Member States, more than necessary.

The normative system of the European Union is based on the principle that when a measure should be applicable, even in detail, in all Member States, then national measures should be replaced by legal acts of the Union and when this is not necessary, should be taken taking into account the existing legal orders of the Member States. In this context, a number of legal instruments have been developed that enabled the institutions of the Union to intervene with various measures in the domestic legal order. As a result, internal norms were replaced by European Community norms.

Today, the European Union also has rules according to which its institutions indirectly influence the legal orders of the Member States. So there are also non-binding acts for Member States or for nationals of the Community.

Keywords: *Community Legal Order; Member States; European Community; Community Law; Treaty on European Union*

Hyrje

Në shekullin e XX – të ka pasur dy konflikte në nivel botëror, që lanë pasoja të mëdha në shtetet e kontinentit europian, të cilat u angazhuan për zbatimin e një projekti shumë ambicioz, atë të një bashkimi të shteteve europiane. Realizimi i politikave për një Europë të bashkuar, ndër të tjera, nënkuptonte angazhimin e shteteve për paqe dhe stabilitet në kontinent. Themelimi i Bashkimit Europian fillimisht krijoi thelbin e kornizës për një rend të ri juridik që do të sillte jo vetëm paqe dhe siguri në Evropë, por do të mundësonte më pas edhe krijimin e kushteve për standart dhe cilësi jete të qytetarëve në Europë.

Objektivi kryesor i Bashkimit Europian ishte garancia për një zhvillim të vazhdueshëm të unitetit mes shteteve të Europës. Uniteti është tema që përsëritet gjithnjë, prandaj rendi juridik që u krijua nga institucionet e Bashkimit Europian synonte krijimin e kushteve për mirëqenien e njerëzve, nxitjen e zhvillimit shkencor e teknologjik, si dhe promovimin e unitetit ekonomik, social, territorial dhe të solidaritetit ndërmjet vendeve anëtare. Njëherazi, Bashkimi Europian u angazhua për të respektuar identitetin kombëtar të çdo vendi anëtar, duke marrë parasysh edhe autonomitë lokale dhe rajonale. Respektimi i funksioneve themelore të Shteteve Anëtare, paraqiste një domosdoshmëri për sigurimin e tërësisë territoriale, zbatimin e ligjit dhe të rendit juridik, si dhe sigurimin e paqes ndërkombëtare.

Pa kohezion të brendshëm mes shteteve anëtare të Bashkimit Europian demokracia, ligji dhe drejtësia, prosperiteti ekonomik dhe siguria sociale, dhe garantimi i tyre për të ardhmen do të ishte i pamundur.

Sot probleme të tilla si papunësia, zhvillimi ekonomik – social i papërshtatshëm, ndotja e ambjentit, konkurrenca e ndershme, konsumizmi etj, nuk janë thjesht çështje të brendshme të shteteve anëtare dhe nuk mund të zgjidhen në nivel nacional. Është fakt që vetëm në kuadër të një Bashkimi Europian të fortë, mund të strukturohet një rend i qëndrueshëm juridiko – ekonomik. Vetëm përmes përpjekjeve të përbashkëta të të gjithë shteteve europiane mund të sigurohet një politikë për krijimin e një rendi juridik komunitar, që të mund të kontribuohet në pasjen e një drejtësie sociale që do të ndikojë në përmirësimin e performancës në unitetin europian.

1. Parimet Themelore të Rendit Juridik Komunitar

Komuniteti Europian u bë një realitet i bashkimit politik – juridik në vitet '90¹. Konsolidimi i Bashkimit Europian imponoi nevojën për të “konceptuar” një sërë aktesh legjislativë të cilat duhet të rregullonin marrëdhëniet mes Unionit dhe Shteteve Anëtare, ndërmjet Shteteve Anëtare, si dhe statusin dhe marrëdhëniet e çdo individi në Bashkimin Europian.

Fillimisht duhej të përcaktohej mirë dhe qartë natyra, dhe efektet e legjislacionit të Komunitetit Europian. Institucionet duhej të ishin në gjendje të harmonizonin në mënyrë efektive dhe të pavarur nga vullneti i Shteteve Anëtare, kushtet e ndryshme ekonomike, sociale dhe madje mjedisore. Harmonizimi mund të realizohej vetëm me anë të miratimit të paketave ligjore të përafërta në shumë Shtete Anëtare, me qëllimin për t’iu ofruar të gjithë shtetasve të Bashkimit kushtet më të mira të mundshme për jetesë. Nga ana tjetër, Institucionet e Bashkimit Europian nuk mund të ndërhyjnë në sistemet juridike të brendshme të Shteteve, më shumë sesa ishte e nevojshme. Traktati i Amsterdimit riafirmoi objektivat e arritura nga traktatet e tjera dhe hodhi hapat për një bashkëpunim juridiko – ekonomik më të fuqishëm në nivel europian.

Traktati i Amsterdimit konsolidoi drejtimit kryesorë mbi të cilat do të mbështetej veprimtaria legjislativë e Bashkimit Europian që prej Traktatit të Maastrichtit. Këto objektiva ishin politika e jashtme dhe e

1 Gjykata Europiane e Drejtësisë trajton parimet themelore të Traktatit të KE konkretisht në dy çështje: 1. Çështjen C-402/05 P dhe 2. Çështjen C-415/05 P.

sigurisë, bashkëpunimi në fushën drejtësisë dhe të punëve të brendshme,² të cilat ndihmuan në afirmimin e parimeve të lirisë, të demokracisë dhe të respektimit të të drejtave të njeriut. Miratimi i këtij Traktati mundësoi krijimin e një hapësire lirie, sigurie dhe drejtësie, duke iniciuar reformimin e institucioneve europiane dhe zgjeruar listën e parimeve themelore, me qëllim garantimin e respektimit të tyre nga të gjitha vendet e Bashkimit European.

Krijimi i një entiteti të madh european, imponoi nevojën për të “konceptuar” disa parime themelore mbi të cilat do të ngrihej i tërë sistemi normativ komunitar.

Parimi kryesor mbi të cilin u mundësua krijimi i rendit juridik komunitar ka natyrë universale dhe bazohet në vlerat e Bashkimit European. Kuadri ligjor mbi të cilin u strukturua rendi juridik komunitar u bazua në respektim të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Të gjitha këto janë vlera të përbashkëta për Shtetet Anëtare, për një shoqëri ku mbizotëron pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis të gjithë njerëzve femrave dhe meshkujve.³

Bashkimi European, edhe pse është një organizim sa i veçantë aq dhe atipik i shteteve europiane, është bazuar në parimin e rëndësishëm për strukturimin e një organizimi politik që ka si qëllim të promovojë paqen dhe harmoninë mes shteteve anëtare. Përparësitë e institucioneve të Bashkimit European orientohen drejt mbrojtjes të vlerave demokratike dhe mirëqenies të popujve të përfshirë në këtë Komunitet⁴.

Përgjatë gjithë rrugëtimit, Bashkimi European është përpjekur që t’u ofrojë qytetarëve të vet liri, siguri dhe drejtësi pa kufij të brendshëm, ku lëvizja e lirë e personave garantohej në pajtim me veprimet dhe masat e duhura.

Themelimi i një tregu të brendshëm ekonomik european solli një zhvillim të madh të ekonomisë të të gjithë shteteve europiane. Parimet mbi të cilat u mbështet integrimi ekonomik u bazuan në zhvillimin e balancuar financiar dhe stabilitetin e çmimeve, në ekonominë konkurrense të tregut social, duke synuar punësim të plotë dhe progres social, si dhe nivel të lartë të mbrojtjes dhe përmirësimit të kualitetit të ambientit jetësor⁵. Integrimi ekonomik pati një impakt pozitiv edhe në përparimin shkencor dhe teknologjik, si dhe solli promovimin e ojë kohezionin ekonomik, social dhe territorial midis Shteteve Anëtare.

Institucionet e Bashkimit European kanë miratuar shumë direktiva dhe rregullore me të cilat janë përpjekur të minimizojnë përjashtimin dhe diskriminimin social dhe të promovojnë drejtësinë dhe mbrojtjen sociale, barazinë midis femrave dhe meshkujve, solidaritetin midis gjeneratave dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Zbatimi i të drejtës konunitare nga Shtetet Anëtare është një çështje që ka një rëndësi të madhe. Faktikisht duhet pranuar se Bashkimi European nuk ka kompetencat e domosdoshme për të zbatuar drejtpërsëdrejti, të drejtën komunitare në Shtetet Anëtare. Gjithashtu Institucionet e Bashkimit European nuk kanë iniciativë të drejtpërdrejtë në ekzekutimin material të rregullave komunitare. Si rrjedhojë e kësaj gjendjeje juridike Bashkimi European duhet të mbështetet në bashkëpunimin e Shteteve Anëtare, qoftë kjo edhe në ato fusha të të drejtës të cilat mbulohen plotësisht nga legjislacioni komunitar.⁶ Për shembull, Komuniteti

2 Për më shumë të dhëna: Traktati I Amsterdamt 2 tetor 1997 (Fletorja Zyrtare e Bashkimit European C 340 datë 10/11/1997)

3 Për më shumë shih neni 2 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit European. (Fletorja Zyrtare e Bashkimit European C 306 datë 17/12/2007)

4 Për më shumë shih neni 3 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit European. (Fletorja Zyrtare e Bashkimit European C 306 datë 17/12/2007)

5 Për më shumë shih neni 4 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit European. (Fletorja Zyrtare e Bashkimit European C 306 datë 17/12/2007)

6 Catherine Barnard and Steve Peers “European Union Law” Third Edition, Oxford University Press, botuar në shtator 2020. ISBN: 9780198855750

ka kompetencë ekskluzive në fushën doganore, por kontrolli i mallrave që kalojnë në kufijtë e jashtëm dhe vjelja e taksave doganore janë materialisht të realizueshme nga funksionarët kombëtarë të Shteteve Anëtare.

Vënia në jetë e detyrimeve që burojnë nga e drejta komunitare, brenda hapësirës të Shteteve anëtare, bazohet në dy parime themelore. Parimi i parë lidhet me detyrimin e shteteve anëtare për një bashkëpunim të frytshëm (të ndershëm apo të pastër) dhe parimi i dytë lidhet me pavarsinë institucionale dhe procedurale të Shteteve Anëtare.

Tërësia e legjislacionit të Bashkimit European dhe rendi i tij juridik mund të mbijetojnë vetëm nëse përputhshmëria dhe ruajtja e këtij rendi juridik komunitar garantohen nga dy parime kryesore: – parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë të të drejtës komunitare dhe parimi i përparësisë të të drejtës komunitare mbi të drejtën kombëtare. Ekzistenca dhe ruajtja e këtyre dy parimeve mundësohet nga interpretimet dhe opinionet e shprehura nga Gjykata së Drejtësisë.

2. Përparësitë e Rendit Juridik Komunitar

Themelimi i Bashkimit European imponoi nevojën për të “konceptuar” një sërë aktesh legislative të cilat duhet të rregullonin marrëdhëniet mes Unionit dhe Shteteve Anëtare, mes Shteteve Anëtare, si dhe statusin dhe marrëdhëniet e çdo individi në Komunitet. Fillimisht duhej të përcaktohej mirë dhe qartë, natyra dhe efektet e legjislacionit që do të krijoheshin dhe më pas zbatoheshin në Bashkimin European. Institucionet e përbashkëta europiane që u krijuan për zbatimin e një të drejte konkrete komunitare duhej të ishin në gjendje të harmonizonin në mënyrë sa më efektive aktet e miratuara me qëllim që të mos kishte diferencime juridike, ekonomike dhe sociale mes Shteteve Anëtare. Qëllimi i vetëm ishte që të gjithë shtetasit e Bashkimit European të përfitonin kushtet më të mira të mundshme për jetesë dhe të mos diferencoheshin për shkak të nacionaliteteve të tyre.⁷

Pavarsisht përparësive që sillte krijimi i një rendi juridik komunitar Institucionet e përbashkëta europiane në asnjë rast nuk mund të ndërhyjnë në sistemet juridike të brendshme të Shteteve Anëtare, më shumë sesa ishte e nevojshme. Pra, i tërë sistemi normativ i Bashkimit European është bazuar në parimin se kur një masë duhet të jetë e zbatueshme, qoftë edhe në detaje, në të gjitha Shtetet Anëtare, atëherë masat kombëtare duhet të zëvendësohen me akte ligjore të Bashkimit dhe kur kjo nuk është e nevojshme, duhen marrë parasysh rendet juridike ekzistuese të Shteteve Anëtare. Në këtë kontekst u zhvilluan një mori instrumentesh që i mundësuan institucioneve të Unionit të ndërhyjnë me masa të ndryshme dhe konkrete në rendet juridike të brendshme. Rasti më drastik është zëvendësimi i normave të brendshme me norma të Komunitetit European.⁸

Megjithatë Bashimi European disponon edhe rregulla në bazë të të cilave institucionet e tij ndikojnë indirekt mbi rendet juridike të Shteteve Anëtare. Për të disiplinuar një rast konkret, mund të merren edhe masa ndaj një subjekti të përcaktuar nominalisht ose të identifikueshëm. Pra, ekzistojnë edhe akte jodetyruese për Shtetet Anëtare apo për shtetasit e Komunitetit Instrumentet juridike që krijojnë tërësinë e të drejtës komunitare që zbatohet në Bashkimin European, në këndvështrimin e subjekteve të cilëve u adresohet dhe efekteve praktike që shkakton kjo e drejtë tek Shtetet Anëtare, janë:

1. Rregulloret të cilat u drejtohen të gjitha Shteteve Anëtare, personave juridikë dhe fizikë. Këto janë akte drejtpërdrejt të zbatueshme dhe detyruese në tërësinë e tyre
2. Direktivat të cilat u drejtohen të gjitha Shteteve Anëtare ose disa Shteteve Anëtare specifike. Këto janë akte detyruese për sa i përket rezultatit të synuar dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme vetëm në rrethana të veçanta

⁷ Programma politico e d'azione della Comunità Europea a favore dell'ambiente e di uno sviluppo sostenibile” (Fletorja Zyrtare e Bashkimit European C 138 17/05/1993).

⁸ Catherine Barnard and Steve Peers “European Union Law” Third Edition, Oxford University Press, botuar në shtator 2020. ISBN: 9780198855750

3. Vendimet të cilat u drejtohen të gjitha Shteteve Anëtare ose Shteteve Anëtare specifike; personave fizikë ose juridikë specifike. Këto janë akte drejtpërdrejt të zbatueshme dhe detyruese në tërësinë e tyre
4. Rekomandimet dhe Opinionet të cilat u drejtohen të gjitha Shteteve Anëtare ose Shteteve Anëtare specifike, organeve të tjera të Bashkimit European, si dhe individëve. Këto janë akte jodetyruese.
5. Rezolutat, Deklaratat dhe Programet e Veprimit, të cilat u drejtohen të gjitha Shteteve Anëtare ose Shteteve Anëtare specifike, si dhe organeve të tjera të Bashkimit European. Këto janë akte jodetyruese.

3. Efektet Kryesore të Rendit Juridik Komunitar

Legjislacioni european sot cilësohet si *acquis communautaire*⁹, ku përfshihen jo vetëm traktatet e Bashkimit European, por edhe aktet e miratuara nga Institucionet e Komunitetit European siç janë rregulloret, direktivat, rekomandimet dhe opinionet, rezolutat, deklaratat dhe Programet e Veprimit.

Traktatet e Bashkimit European në asnjë dispozitë nuk shprehen konkretisht për prioritetin e të drejtës komunitare, por efektet që prodhon kjo e drejtë vijnë në kontekst të mirëkuptimit të arritur mes shteteve anëtare¹⁰. Në kuadër të detyrës së saj për të siguruar respektimin e të drejtës komunitare, Gjykata e Drejtësisë është shprehur edhe për prioritetin e kësaj të drejte në krahasim me të drejtën e brendshme të Shteteve Anëtare. Ajo çfarë është e rëndësishme për efektet prioritare të të drejtës komunitare janë pasojat që duhet të vijnë që Gjykata e Drejtësisë shpreh në vendimmarrjen e saj në zbatim të parimit të epërsisë të të drejtës komunitare.¹¹

Vendimmarrjet e Gjykatës së Drejtësisë janë të detyrueshme për Shtetet Anëtare. Detyrueshmëria realizohet në dy aspekte. Së pari në kontekst të ndikimit që do të knë në rendin e brendshëm juridik të çdo shteti, pasi mund të shërbejnë si bazë juridike për interpretimin dhe zgjidhjen rast pas rasti të problematikave të ndryshme. Së dyti vendimmarrjet e Gjykatës së Drejtësisë prodhojnë efekte juridike konkrete mbi sistemin kushtetues kombëtar të secilit Shtet Anëtar. Në këtë aspekt e drejta komunitare ka epërsi mbi të drejtën e brendshme të Shteteve Anëtare.

Fuqia ekzekutive e të drejtës komunitare nuk duhet të jetë e ndryshme nga një Shtet Anëtar në Tjetrin, apo në favor të legjislacioneve të brendshme me fuqi më të pakët, pasi kështu do të vihej në rrezik qëllimi i Traktateve dhe do të provokohej diskriminim mes Shteteve Anëtare të Unionit.¹²

Implementimi i plotë i të drejtës komunitare do të sillte pamundësi që Shtetet Anëtare të vlerësonin, kundër rendit juridik komunitar të pranuar nga ata vetë mbi bazën e reciprocitetit, një normë juridike më të ulët (kombëtare) e cila do të ishte në kundërshtim me këtë rend juridik.¹³ Gjithashtu edhe forca ekzekutive e të drejtës komunitare nuk duhet të jetë e ndryshme nga një Shtet Anëtar në Tjetrin, në favor të legjislacioneve të brendshme me fuqi më të pakët, pasi kështu do të vihej në rrezik qëllimi i traktatit.¹⁴

Efkti i epërsisë e të drejtës komunitare është pohuar nga neni 189 i TKE – së, sipas të cilës rregulloret kanë vlerë të detyrueshme dhe janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Shtetet Anëtare. Sipas këtij përcak

9 Shqipërimi I termit është e drejta komunitare

10 Catherine Barnard and Steve Peers “European Union Law” Third Edittion, Oxford University Press, botuar në shtator 2020. ISBN: 9780198855750

11 Për më shumë shih nenet 251 – 281 për GJED të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU).

12 Shih neni 5 dhe neni 7 i TFBE

13 Shih neni 5 i TFBE

14 Shih neni 7 i TFBE

timi asnjë Shtet Anëtar nuk mund të ketë rezerva ligjore në zbatimin e të drejtës komunitare, por duhet ta zbatojë dhe ta pranojë atë të plotë.

Praktikisht implementimi i të drejtës komunitare në të drejtën e brendshme të secilit Shtet Anëtar shoqërohet me një kufizim të mirëpërcaktuar të të drejtave të tyre sovrane. Kjo do të thotë që Shtetet Anëtare nuk mund të vlerësojnë një akt juridik të brendshëm i cili është i papajtueshëm me të drejtën e krijuar nga Komuniteti. Si pasojë në çdo rast që para një juridiksioni kombëtar shtrohet një kërkesë për interpretim traktati, atëherë duhet të aplikohet e drejta komunitare dhe jo e drejta (ligji) kombëtar.

E drejta komunitare dhe të drejtat kombëtare të Shteteve Anëtare ndërveprojnë mes tyre në ato fusha ku këto dy sisteme plotësojnë njëri – tjetrin. Në bazë të parimit të bashkëpunimit reciprok dhe të sinqertë, Bashkimi European dhe Shtetet Anëtare, në respektim të ndërsjelltë, ndihmojnë njëri – tjetrin në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga Traktatet.

Shtetet Anëtare kanë detyrimin që të marrin masat e duhura, të përgjithshme ose të posaçme, për të siguruar plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet ose nga aktet e institucioneve të Bashkimit. Gjithashtu duhet të mundësojnë arritjen e detyrave të lëna nga Institucionet e Bashkimit European duke hequr dorë nga çdo masë, që mund të vërë në rrezik arritjen e objektivave të Komunitetit¹⁵.

Bashkëpunimi i sinqertë mes Shteteve Anëtare u frymëzua nga ndërgjegjësimi që rendi juridik komunitar praktikisht nuk është në kushtet dhe mundësitë që të realizojë të gjitha objektivat e caktuara me krijimin e Bashkimit European. Kjo për arsye se rendi juridik komunitar ndryshe nga rendi juridik kombëtar, nuk është një sistem i pavarur, por për funksionimin e tij bazohet në mbështetjen që i bëhet nga sistemet kombëtare të secilit Shtet Anëtar. Prandaj çdo Shtet Anëtar duhet të pranojë që rendi juridik komunitar nuk është një sistem ‘i huaj’ për të drejtën e brendshme.

Institucionet e Bashkimit European dhe Shtetet Anëtare kanë krijuar hallka të pazgjidhshme ndërmjet tyre, me qëllim që të arrijnë objektiva të përbashkëta. Bashkimi European nuk është vetëm një Komunitet i interesave, por është edhe një Komunitet i bazuar në solidaritet. Si pasojë nga autoritetet kombëtare kërkohet jo vetëm të respektojnë Traktatet dhe legjislacionin dytësor, por duhet gjithashtu që ta zbatojnë atë dhe ta venë në praktikë. Ndërveprimi ndërmjet të drejtës komunitare dhe të drejtave të brendshme të secilit Shtet Anëtar duhet të jetë i shumanshëm.

Në fushën e gjyqësorit, dy sistemet ndërthuren përmes procedurës së vendimmarrjes paragjykimore¹⁶ sipas të cilës gjykatat kombëtare mund ose ndonjëherë duhet t’i drejtojnë Gjykatës së Drejtësisë pyetje për interpretimin dhe vlefshmërinë e së Drejtës së Bashkimit. Vendimet e gjykatës mund të jenë vendimtare për zgjidhjen e konfliktit. Bazuar në interpretimin e dispozitës 267 TFBE dy gjëra duhet të jenë të qarta:

- Së pari gjykatave në Shtetet Anëtare u kërkohet të respektojnë dhe të zbatojnë të drejtën komunitare.
- Së dyti interpretimi i të drejtës komunitare dhe deklaratimet për vlefshmërinë e saj janë detyrë vetëm e Gjykatës së Drejtësisë.

Ndërveprimi i të drejtës komunitare dhe të drejtave kombëtare është i nevojshëm kur zbatimi bëhet me qëllim plotësimin e boshllëqeve në të drejtën komunitare.

E drejta e komunitare mund ti referohet normave ekzistuese të së drejtës kombëtare për të plotësuar normat që përcakton ajo vetë. Ky parim vlen për të gjithë tërësinë e detyrimeve që rrjedhin prej të drejtës komunitare, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit ka përcaktuar rregulla për zbatimin e tij. Në çdo rast të tillë, autoritetet kombëtare zbatojnë të drejtën komunitare duke e përshtatur atë me dispozitat e sistemeve

15 Shih Neni 4 (3) i TBE

16 Neni 267 i TFBE

të tyre juridike. Megjithatë ky parim i nënshtrohet një kushti. Në çdo rast duhet të ruhet zbatimi uniform i të drejtës komunitare, sepse do të ishte tërësisht e papranueshme që shtetasit dhe sipërmarrjet të gjykojnë bazuar në kriteret e ndryshme (bazuar në të drejtat kombëtare), duke u trajtuar kështu padrejtësisht.¹⁷

Përfundime

Projekti i Bashkimit European është zhvilluar nëpërmjet shumë iniciativave dhe instrumenteve ligjore. Traktatet janë themelet e Bashkimit European, të cilat përcaktojnë rregullat dhe procedurat që institucionet e Bashkimit European duhet të ndjekin. Traktatet hanë aktet themelore ku u bazua krijimi i një rendi të ri juridik kushtetues mbi të cilin u strukturua komunitet i shteteve europiane. Pikërisht bazuar mbi këtë rend juridik komunitar u ngritën institucionet e Bashkimit European dhe u rregullua funksionimi i tyre.

Parimisht e rendi juridik komunitar jo vetëm ndërthuret, por edhe plotëson të drejtat e brendshme kombëtare¹⁸. Shtetet Anëtare kanë detyrimin që nëpërmjet autoriteteve kombëtare të vendosin si dhe me çfarë mënyre do të arrihet në fund rezultati i kërkuar nga zbatimi i të drejtës komunitare.

E drejta komunitare ka një natyrë sa origjinale aq dhe të pavarur. Gjithashru ajo shpreh një rend juridik të ri të së drejtës në Evropë. Kjo është risia kryesore e Bashkimit European dhe çfarë e dallon atë prej përpjekjeve të mëparshme për të unifikuar Europën, pasi ajo funksionon jo bazuar në detyrimin apo shtrëngimin, por thjesht përmes forcës së ligjit.

E drejta komunitare duhet të bazohet në unitetin me vullnet të lirë të secilit Shtet Anëtar, për sa kohë që synon të reflektojë vlera themelore, si liria dhe barazia. Praktikisht traktatet që krijuan Bashkimin European si një entitet u bazuan mbi këtë koncept. Dispozitat e të drejtës komunitare kanë aftësinë që tu lejojnë qytetarëve të Bashkimit European të mbeshteten në to dhe t'i drejtohen gjykatave të Shteteve Anëtare ku të kërkojnë zbatimin e tyre.

Strukturimi i Bashkimit European është bazuar tek e drejta komunitare. Jetën ekonomike, sociale dhe financiare të popujve të Shteteve Anëtare nuk e disjolinon shtrëngimi nëpërmjet sanksionit, por e drejta komunitare, e cila është baza e sistemit institucional, pasi përcakton procedurat e vendimmarrjes të institucioneve të Bashkimit European dhe rregullon marrëdhëniet mes tyre. Rendi juridik komunitar përbëhet nga aktet ligjore urdhëruese siç janë rregulloret, direktivat dhe vendimet, të cilat janë të detyrueshme për Shtetet Anëtare dhe shtetasit e tyre. Për rrjedhojë, vetë individët bëhen fokusi kryesor i Bashkimit European, rendi juridik i të cilit ndikon gjithnjë e më drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme. Ky rend juridik jep të drejta dhe u vendos detyrime në mënyrë që çdo individ qoftë në cilësinë e shtetasit të një Shteti Anëtar, qoftë në cilësinë e Qytetarit European, t'i nënshtrohet një hierarkie rendesh juridike, siç ndodh edhe në sistemet kushtetuese federale.

Rendi juridik komunitar është themeli i vërtetë i Bashkimit European, sepse i jep atij karakterin e një “Komuniteti të të Drejtës”. Vetëm duke krijuar një legjislacion të ri dhe duke e zbatuar atë, mund të arrihen objektivat themelorë të Bashkimit European. Gjithashtu, e drejta komunitare përcakton marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit European dhe Shteteve Anëtare, ku këta të fundit duhet të miratojnë të gjitha masat e duhura për të garantuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktate. Rendi juridik i Bashkimit European ka arritur tashmë shumë në këtë drejtim. Falë këtij rendi të ri juridik, hapja e kufijve në shkallë të gjerë, tregtia me mallra dhe shërbime, migrimi i punëtorëve dhe numri i madh i lidhjeve ndërkombëtare

17 Catherine Barnard and Steve Peers “European Union Law” Third Edition, Oxford University Press, botuar në shtator 2020. ISBN: 9780198855750

18 Gjithçka që një direktivë e përcakton me terma të detyrueshëm, është rezultati që duhet arritur nga Shteti Anëtar

ndërmjet kompanive në tregun e përbashkët, janë pjesë e jetës së përditshme për miliona njerëz që jetojnë në një Europë pa kufij.

Si çdo rend juridik, edhe rendi juridik i Bashkimit European përbën një sistem të pavarur të mbrojtjes juridike, që shërben për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe për zbatimin e të drejtës komunitare. Vendim-marrjet e Gjykatës së Drejtësisë garantojnë zbatimin uniform dhe me përparësi të të drejtës komunitare në të gjitha Shtetet Anëtare. Rendi juridik komunitar me të gjitha mangësitë e tij, jep një kontribut të çmuar për zgjidhjen e problemeve politike, ekonomike dhe sociale të Shteteve Anëtare të Bashkimit European.



**SHKENCAT
E
APLIKUARA
DHE
EKONOMIKE**

SEKSIONI 3

